



Të dashur Prindër dhe Familje,

Përkushtimi juaj për Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, është i forte dhe shumë i vyer, ndaj ne sinqerisht besojmë se ju duhet të informoheni për zhvillimet e rëndësishme më të fundit në Drejtorinë tonë Arsimore. Kjo është arsyeja që duhet të flasim me ju për zhvillimet që lidhen me Unionin e Mësuesve të Filadelfias (PFT).

Pas gati dy vite negociatash me PFT, për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, që përfshin benefitet dhe kontributet në siguracionin e shëndetit, në ngjashmëri edhe me punonjësit e tjerë dhe Drejtoritë Arsimore analoge, në rang shteti dhe kombëtare, ne jemi larg arritjes së një marrëveshjeje.

Ndërkaq, konditat e klasave dhe shkollave tona nuk janë të mira dhe në mungesë të marrjes së fondeve, do të përkeqësohen. Komisioni i Reformës Shkollore, sot ushtroi autoritetin e tij për anulimin e kontratës me PFT, në mënyrë që të realizojë ndryshimet për planet dhe kontributet në sigurimin shëndetësor nga punonjësit e saj.

Veprimi i sotëm do të adresojë 43.8 milion \$ në shkollat tona, vetëm këtë viti shkollor. Në vazhdim, Drejtoria Arsimore do të kursejë 10 milion \$ në fondet federale, të cilat do përdoren për mësim shtesë, për pjesën më në nevojë të popullatës. Gjatë katër viteve të ardhëshme, këto kursime mendohet të arrijnë një total prej \$198.5 milion në fonde operative dhe \$47 milion, në fondet federale.

Ju lutemi shikoni informacionin për burimet financiare që ne do t'i adresojmë në shkolla, bashkëngjitur kësaj letre.

Duke kërkuar prej mësuesve dhe personelit tjetër që të kontribuojnë për sigurimin shëndetësor, është një ndryshim dhe një sakrificë, por kontributi në sigurimin shëndetësor është një realitet i fuqisë punëtore në ditët e sotme. Punonjësit e tjerë të Drejtorisë Arsimore, përfshirë Drejtorët, punonjësit ndihmës dhe personeli në zyrat qëndrore, i kanë miratuar këto kontribute të ngjashme.

Ne e mbështetim të drejtën e punonjësve tanë të përfaqësohen prej PFT dhe mbetemi të përkushtuar për arritjen e një marrëveshje të re për pagat, rregullat e punës dhe çështjeve të tjera, që negocohen me sindikatën.

Qëllimi ynë i vetëm është të fokusohemi për realizimin e mjedisit më të mirë mësimor për të gjithë nxënësit tanë. Ne e kuptojmë që të gjithë punonjësit e Drejtorisë bëjnë sakrifica të mëdha çdo ditë, në të mirë të nxënësve dhe shkollave tona. Megjithatë, burimet e kufizuara financiare, kërkojnë vendime të vështira. Unë ju lutem të vazhdoni të ngrini zërin dhe të kontaktoni përfaqësuesit tuaj të zgjedhur që të luftoni bashkë me mua, SRC dhe të tjerët, për fonde shtesë, dhe një formulë sa më të drejtë për financimin e edukimit publik në rang shteti.

Ju falenderoj për mbështetjen tuaj të vazhdueshme.

Sinqerisht,

William R. Hite, Ed.D.